REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
TREGU I SHITJES ME SHUMICË FRUTA – PERIME SH.A. SHKODËR

Adresa: km 2 rruga nacionale Shkoder – Hani i Hotit tel/fax +355 262 20 990/262 20 991, email: tregufrutaperimesh@gmail.com

## KËSHILLI MBIKQYRËS I SHOQËRISË

## VENDIM

*Nr.* 3 *datë* 14/01/2014

**"Për emërimin në detyrën e Drejtorit të Shoqërisë"**

Mbështetur në Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar; Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe nenet 13, 14, 15 të Statutit të Shoqërisë "Tregu I Shitjes Me Shumicë Fruta – Perime Sh.A. Shkodër", vendosi:

1. **Emërimin në detyrën e Drejtorit të Shoqërisë të z. Vinko Nikprelaj.**
2. **Marrëdhëniet e punës, të drejtat dhe detyrimet e palëve rregullohen sipas Kontratës Individuale të Punës që do të lidhet midis Këshillit Mbikqyrës, përfaqësuar nga Kryetari, dhe z. Vinko Nikprelaj.**
3. **Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

KRYETARI

Geron IBRAHIMI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – TREGU I SHITJES ME SHUMICË FRUTA PERIME SHA – SHKODËR

# VENDIM

# I

## Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë "Tregu i Shitjes me Shumicë " Fruta Perime" SHA Shkodër

**Nr. 1 datë 7.5.2018**

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve e shoqërisë "Tregu i Shitjes me shumicë "Fruta Perime" SHA, Shkodër me aksionar Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e cila zotëron 67.22 % të aksioneve dhe përfaqësohet nga Z. Stefanaq Kocollari, me autorizim të Ministrit me nr.7678/2 datë 4.5.2018, dhe Bashkia Shkodër, në mbledhjen e datës 7.5.2018 ora 10.00, mbështetur në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", zotëruese e 32.78 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, pas shqyrtimit të pikave të rendit të ditës;

**VENDOSI:**

1. Lirimin e Z. Vinko Nikprelaj, nga detyra e Administratorit të shoqërisë " Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta Perime" Shkodër.

2. Emërimin e Z. Dritan Pirani në detyrën e Administratorit të shoqërisë " Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta Perime" Shkodër.

3. Miraton statutin e ri të shoqërisë " Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta Perime" Shkodër.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Përfaqësuesi i MFE-së** | **Administratori**

**Stefanaq Kocollari** | **Dritan Pirani**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 8480 Kol
Nr. 3248 Rep

# KONTRATE SHIT-BLERJE PJESES KAPITALI

Sot, më datë 14.12.2006 (dy mijë e gjashtë) përpara meje, noteres ........ me adresë në ........ Shqipëri, u paraqitën personat e mëposhtëm:

A. **Berlinwasser International AG**, një shoqëri e krijuar dhe që funksionon në përputhje me legjislacionin Gjerman, e regjistruar në Gjykatën Lokale të Berlinit (*Amtsgericht Berlin*) me numër regjistri HR B 87833 dhe me seli në Stralauer Straße 32, 10719 Berlin, Gjermani (këtu dhe më poshtë e quajtur "**BWI**"), e përfaqësuar rregullisht nga Z. Ulrich-Wilhelm Herwarth Ernst Pohl, lindur me 7 Mars 1953, ne Bonn Gjermani, në përputhje me Vendimin e lëshuar nga Drejtori i Vetëm Ekzekutiv Z. Dieter Ernst i cili ka tager të vetëm përfaqësimi, bashkengjitur ne (**Aneksi 1**).

B. **Rodeco Consulting GmbH**, një shoqëri e krijuar dhe qe funksionon në përputhje me legjislacionin Gjerman, e regjistruar me Gjykatën Lokale të Bad Homburg (*Amtsgericht Bad Homburg*) me numër regjistri HRB 2022 dhe me seli në Ferdinandstr. 17a, 61348 Bad Homburg, Gjermani (këtu dhe më poshtë e quajtur "**Rodeco**"), e përfaqësuar rregullisht nga Z. Ulrich-Wilhelm Herwarth Ernst Pohl, lindur me 7 Mars 1953, ne Bonn Gjermani, në përputhje me Vendimin e Shoqerise lëshuar nga nga Administratorët e shoqërisë Z. Gabriele Holder dhe Ulrich Goerschel, të cilët përfaqësojnë së bashku shoqërinë, bashkengjitur ne (**Aneksi 2**),---------------------------------------------------------

(BWI dhe Rodeco së bashku do të referohen në këtë kontratë si "**Shitësit**")

dhe:

C. **Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikes**, përfaqësuar nga Ministri Z. Genc Reuli, sipas VKM N.743, date 1/11/2006, bashkengjitur si Aneksi 3 (këtu dhe më poshtë referohet si "**Bleresi**").

të cilët përpara meje hartuan sa më poshtë:

## Preambula

BWI është ortak me 80,925 kuota në kapitalin themeltar të shoqërisë Elber Sh.p.k (këtu dhe më poshtë e quajtur "Shoqëria") kapital i cili ndahet në 83,000 kuota me vlerë nominale 1,000 secila. Pjesa e mbetur e kuotave i takon ortakut tjetër Rodeco.

Shoqëria është një shoqëri projekt e cila merret me të ashtuquajturin "Projektin e ujit të pijshëm dhe ujrave të zeza të Elbasanit" në përputhje me marrëveshje të ndryshme projekti, ndër të cilat edhe Marrëveshja e Konçesionit e lidhur mes Republikës së Shqipërisë, Bashkisë

dhe Berlinwasser International GmbH në datë 20 Tetor 2000 ( "Projekti"). Për shkak të, ndër të tjerave, vështirësive financiare të Shoqërisë, Shitësit nuk kanë qëllim të vazhdojnë më tej përfshirjen e tyre në Projekt. Cështjet e ndryshme që janë ngritur në lidhje me Projektin dhe Shoqërinë janë diskutuar në detaje mes Republikës së Shqipërisë dhe Blerësit dhe ky i fundit është i ndërgjegjshëm mbi vështirësitë përkatëse, problemet dhe çështjet. Republika e Shqipërisë janë informuar në veçanti se shoqëria është e mbingarkuar në detyrime. Shoqëria ka përgatitur pasqyrat e perkohshme për periudhën financiare Janar – Nentor 2006. Llogaritë vjetore të Shoqërisë deri më 31 Dhjetor 2005 dhe pasqyrat financiare janë bashkangjitur kësaj kontrate në **Aneksin 4**. Palët kanë qëllim që të mbyllin në mënyrë miqësore përfshirjen e Shitësve në Projekt dhe në Shoqëri, ndër të tjera duke transferuar kuotat e shoqërisë tek Blerësit.

**1. Objekti i Blerjes**

**1.1** Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar rregullisht dhe që funksionon në mënyrë të rregullt në përputhje me legjislacionin Shqiptar, regjistruar me Regjistrin Tregëtar të Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë me numër regjistri 24764 me seli në adresën Ndermarrja e Ujesjelles Kanalizimeve e Qytetit Elbasan, Lagjia Kala, Elbasan, Shqipëri. Shoqëria ka një kapital themeltar të regjistruar në shumën e *83,000,000* LEK (tetëdhjetë e tre milion LEK) i cili është i shlyer plotësisht në cash.

**2. Blerja e Kuotave**

**2.1** BWI është ortak i 80,925 nga 83,000 kuota në Shoqëri, secila me një vlerë nominale prej 1,000 Lekësh. Pjesa tjetër e kuotave zotërohet nga Rodeco. Duke nenshkruar kete Kontrate Shitësit kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes (Neni 4.10 i Statutit) kundrejt njeri-tjetrit.

**2.2** BWI me anë të kësaj kontrate i shet dhe transferon të gjitha kuotat e saj në Shoqëri të cilat korrenspondojnë me një kontribut në kapitalin fillestar të barabartë me *80,925,000* LEK *(në fjalë: tetëdhjetë million e nëntëqind e njëzetë e pesë mijë* ("Kuotat e Kapitalit të BWI") tek Blerësi dhe Blerësi blen dhe fiton pronësinë e Kuotave të Kapitalit të BWI.

**2.3** Rodeco me anë kësaj kontrate i shet dhe transferon të gjitha kuotat e saj në Shoqëri të cilat korrenspondojnë me një kontribut në kapitalin fillestar të barabartë me *2,075,000* LEK *(në fjalë: dy million e shtatëdhjetë e pesë mijë* ("Kuotat e Kapitalit të Rodeco") tek Blerësi dhe Blerësi blen dhe fiton pronësinë e Kuotave të Kapitalit të RODECO.

**2.4** Kuotat e Kapitalit të BWI dhe Rodeco transferohen dhe pranohen me anë të kësaj kontrate dhe do të bëhen menjëherë pronësi e Blerësit, në përputhje me Statutin e Shoqërisë si dhe çdo të drejtë apo detyrim tjetër që buron prej tij. E drejta e fitimeve të Shoqërisë sipas pjesës përkatëse të kuotave, nëse ka të tillë, transferohet duke filluar nga data 1

Dhjetor 2006 që do të thotë se të gjitha shpërndarjet e dividendit, nëse ka, i kalojnë Blerësit që nga data 1 Dhjetor 2006.

2.5 Shitësit do të sigurojnë se çdo ndryshim në pronësinë dhe titullin e Kuotave të Kapitalit do të regjistrohen në Librin e Kuota-Mbajtësve në përputhje me Nenin 4.5 të Statutit Brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje.

**3. Cmimi i Blerjes**

3.1 Çmimi i Blerjes për Kuotat e Kapitalit të BWI-së është i barabartë me 9.750 LEK (në fjalë: nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) dhe çmimi i blerjes për Kuotat e Kapitalit të Rodeco është i barabartë me 250 LEK (në fjalë: dyqind e pesëdhjetë)

**4. Deklarime dhe Garanci**

4.1 Shitesit dhe Blerësi secili garantojnë se në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, ata kanë të drejtë të plotë që të lidhin këtë Marrëveshje.

4.2 Shitesit garantojnë se në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, secili ka të drejtë të plotë që të shesë Kuotat përkatëse të Kapitalit tek Blerësi.

4.3 Shitesit garantojnë se, ne lidhje me pronesine e Kuotave përkatëse të Kapitalit në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, ata kane titull te vlefshëm, të lirë nga çdo barrë apo peng mbi Kuotat e Kapitalit dhe se këto Kuota Kapitali janë të lira dhe të paprekura nga ndonjë e drejtë e palëve të treta.

4.4 Me kerkese te Bleresit dhe ne menyre qe te sigurohet, nje tranzicion i bute dhe vazhdimesia e furinizimit me uje si dhe te ruhet programi i investimeve ne qytetin e Elbasanit, BWI konfirmon angazhimmin e tij per te mbeshtetur projektin duke:

- Vazhduar Marreveshjet e Konsulences dhe ate Inxhinjerike te dates 24 Shtator 2002, pasi te jene bere ndyshimet e nevojshme

- Te hyje ne marreveshje per delegimin ne Elber Sh.p.k te stafit kryesor drejtues i/te cilet do te jene te punesuar nga BWI, ne menyre qe te mbeshtetet vazhdimesia e derjtimit te shoqerise, per nje periudhe te caktuar kohe

4.5 BWI eshte e pergatitur te vazhdoje mbikqyrjen e realizimit te investimeve ne Shoqerine Elber Sh.p.k. Kushtet e kontrates ne lidhje me kete sherbim do te perpilohen ne Aneksin N.2 te Kontrates se Konsulences lidhur ndermjet Elber Sh.p.k, perfaqesuar nga KfW, dhe BWI e dates 24 Shtator 2002.

4.6 Cdo garanci e mëtejshme e Shitësve dhe çdo riparim apo pretendim i Blerësit kundër Shitësve në lidhje me Kuotat përkatëse të Kapitalit dhe/ose Shoqërisë, përjashtohet nga kjo Marrëveshje në masën e lejuar dhe në mënyrë të pavarur nga dispozitat ligjore. Në asnjë rast, Shitësit nuk mund të jenë përgjegjës përpara Blerësit për dëme penalizuese, aksidentale, jo të drejtpërdrejta, të veçanta apo që vijnë si pasojë të tilla si humbje e të ardhurave apo fitimeve. Në asnjë rast, detyrimi total maksimal i secilit prej Shitësve

kundrej Blerësit (a) në lidhje me ndonjë apo të gjitha pretendimet për shkelje të deklarimeve dhe garancive të Shitësve, premtimeve, marrëveshjeve apo detyrimeve në përputhje me këtë Marrëveshjeje apo nënshkrimin e saj dhe çdo kontrate, aneksi apo dokumenti të lidhur me të; dhe (b) që lidhet në ndonjë formë tjetër me këtë Marrëveshje apo kontratë, aneks apo dokument të parashikuar në të ose transaksionet e parashikuara në këtë Marrëveshje apo dokumentet e lidhura me të, duke përfshirë në çdo rast dhe të gjitha tarifat, shpenzimet, kostot apo humbjet e tjera, nuk do të kalojnë Cmimin përkatës të blerjes të paguar nga Bleresi në përputhje me Seksionin 3.1.

Blerësi me anë të kësaj Marrëveshje, heq dorë në mënyrë të shprehur nga të gjitha riparimet, garancitë dhe pretendimet në lidhje me Kuotat përkatëse të Kapitalit dhe/ose Shoqërisë për sa kohë këto lidhen me Shitësit pavarësisht nëse Blerësi ka qënë apo mund të ishte në dijeni të këtyre riparimeve, garancive apo pretendimeve apo gjendjes së tyre faktike në kohën e bërjes së Marrëveshjes.

4.7 Bleresi bie dakord se me nenshkrimin e Kontrates se Shit-Blerjes se Kuotave, statusi ligjor dhe ose objekti i veprimtarise se shoqerise Elber Sh.p.k nuk do te cenohen. Palet bien dakord, gjithashtu qe Elber Sh.p.k do te njohe dhe ruaje te gjithe detyrimet kontraktore me palet e treta dhe vecanerisht ato qe burojne nga:

- Marreveshjen e Koncesionit;

- Marreveshjen per kalimin e financimit;

- Marreveshjen e Konsulences te dates 24 Shtator 2002

4.8 Blerësi nëpërmjet kësaj kontrate heqe dorë nga çdo pretendim kundër Shitësve, organeve të tyre, agjentëve, pumarrësve apo përfaqësuesve të tjerë të lidhur me angazhimin e Shitësve në sektorin e ujrave dhe ujrave të zeza në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht nga dispozitat ligjore apo fakti se Blerësi ishte apo mund të kish qënë në dijeni të këtyre pretendimeve, sidoqoftë, në masën që pretendime të tilla ekzistonin dhe/ose faktet për këto pretendime ekzistonin në kohën e bërjes së Marrëveshjes. Blerësi nëpërmjet kësaj marrëveshje, heqe dorë në mënyrë të shprehur nga këto pretendime.

Blersi do të sigurojë se asnjë autoritet tjetër Shqiptar përveç tij dhe asnjë agjent, i punësuar apo përfaqësues i Republikës së Shqipërisë apo Blerësit apo ndonjë autoriteti tjetër Shqiptar nuk do ngrejë ndonjë pretendim të asnjë lloji kundër Shitësve apo ndonjë prej organeve, agjentëve, punëmarrëve apo përfaqësuesve të tyre.

Palët pranojnë në veçanti se Blerësi dhe cdo nëpunës, agjent, punonjës apo përfaqësues i tyre nuk do të ketë asnjë pretendim kundër Shitësve i cili lidhet me Marrëveshjen e Konçesionit dhe çdo marrëveshje të nënshkruar në lidhje me Projektin, me përmbushjen sipas këtyre marrëveshjeve dhe/ose çdo aktivitet tjetër të kryer në lidhje me Projektin dhe/ose sektorin e ujrave dhe ujrave të zeza në Republikën e Shqipërisë nga secili prej Shitësve.

Palët më tej merren vesh se në asnjë rast Shitësit nuk të jenë përgjegjës përpara Republikës së Shqipërisë dhe Blerësit për dëme penalizuese, aksidentale, jo të

drejtpërdrejta, të veçanta apo që vijnë si pasojë, të tilla si pretendime ne lidhje me fitimin e munguar në lidhje me Marrëveshjen e Konçesionit apo çdo marrëveshje tjetër të lidhur me Projektin, përmbushjen sipas marrëveshjeve të sipërpërmendura dhe/ose çdo aktivitet tjetër të kryer në lidhje me Projektin dhe/ose sektorin e ujrave dhe ujrave të zeza në Republikën e Shqipërisë nga ndonjëri prej Shitësve.

Në asnjë rast, përgjegjësia maksimale totale e secilit prej Shitësve kundrejt Blerësit (duke përfshirë në çdo rast dhe çdo tarifë, shpenzim, kosto apo humbje të tjera të lidhura me të) nuk do të kalojë çmimin e blerjes të paguar nga Bleresi, përkatësisht sipas Sektorit 3.1.

Për shmangien e çdo dyshimi, kjo Marrëveshje dhe çmimi i blerjes i paguar në përputhje me të, zgjidh çdo pretendim që Blerësi dhe çdonjëri prej nëpunësve, agjentëve, punonjësve dhe përfaqësuesve të tyre mund të kenë kundër Shitësve në mënyrë përfundimtare dhe të detyrueshme.

## 5. Dispozita Përfundimtare

**5.1** Shpenzimet noteriale që lidhen me këtë akt noterial dhe shpenzimet që vijnë si pasojë e njoftimit të kësaj Marrëveshje në gjykatën përkatëse Shqiptare për regjistrim në regjistrin tregëtar do të ndahen në mënyrë të barabartë midis Palëve.

**5.2** Blerësi është ai të cilit do t'i ngarkohen të gjitha taksat apo tatimet e kërkuara për t'u paguar në përputhje me legjislacionin Shqiptar përsa i takon transaksioneve të parashikuara në këtë Marrëveshje, taksa dhe shpenzime këto të cilat nuk janë përfshirë në çmimin e blerjes. Ndryshimet apo shtesat në këtë Marrëveshje janë të vlefshme vetëm nëse bëhen me shkrim. Nuk do të ketë marrëveshje shoqëruese verbale.

**5.3** Kjo Marrëveshje dhe të gjitha mosmarrëveshjet e lindura prej saj do të rregullohen nga ligji Gjerman si dhe dispozitat urdhëruese të legjislacionit përkatës Shqiptar.

Dispozitat që kanë lidhje me të drejtat e pronësisë sipas kësaj marrëveshje do të rregullohen nga legjislacioni Shqiptar.

Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga, apo në lidhje me këtë Marrëveshje apo vlefshmërinë e saj do të zgjidhen në mënyrë përfundimtare me arbitrazh në përputhje me rregullat e arbitrazhit UNCITRAL që janë aktualisht në fuqi. Autoriteti caktues është Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar në Londër.

**5.4** Në rast se një apo më shumë dispozita të kësaj Marrëveshje janë, apo do të gjykohen se janë të pavlefshme apo të pazbatueshme, vlefshmëria apo zbatueshmëria e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshje nuk do të preket. Në këtë rast, palët pranojnë të njohim dhe japin fuqi atyre dispozitave të vlefshme apo zbatueshme që i korrenspondojnë më tepër

qëllimit tregëtar të palëve. I njëjti parashikim do të zbatohen nëse Marrëveshja përmban ndonjë boshllëk (mos parashikim).

**5.5** Personat e paraqitur përpara meje, pohojnë se përmbajtja e plotë e këtij akti noterial për bën marrëveshjen e plotë ndërmjet Palëve.

**5.6** Kopje autentike të këtij akti noterial mund të lëshohen drejt palëve të tij si dhe trashëgimtarëve apo pasuesve të tyre ligjorë si edhe Shoqërisë, në çdo kohë, me kërkesën e parë të palëve dhe me shpenzimet e tyre.

**5.7** Unë noteri, vërtetoj se kjo kontratë është regjistruar, lexuar në prani të palëve të pran ishme me zë të lartë ne prani e perkthyeses angleze Znj. Jonida Mustafaraj e njohur personalisht prej meje dhe pasi eshte pranuar se reflekton në mënyrë korrekte dhe të vërtetë vullnetin e subjekteve të përfaqësuar prej tyre dhe nënshkruar përpara meje, Noterit të poshtëshënuar.

**Lista e Anekseve**

| | |
|---|---|
| Aneks 1 | Prokurë Përfaqësimi BWI |
| Aneks 2 | Prokurë Përfaqësimi RODECO Consulting GmbH |
| Aneks 3 | VKM N.734, date 1/11/2006 |
| Aneks 4 | Pasqyrat Financiare 2005 dhe Pasqyrat Financiare te Perkohshme 2006 |

**SHITESIT**

(Berlinwasser International AG)

(RODECO Consulting GmbH)

Perfaqesuar me Prokure nga

Ulrich-Wilhelm Herwarth Ernst Pohl

**BLERESI**

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes

Perfaqesuar nga

**Perktheu: Jonida Mustafaraj**

**NOTERE**

# AKT-THEMELIMI
## I SHOQËRISË "TREGU I SHITJES ME SHUMICË TË FRUTA PERIMEVE" SH.A. SHKODER

Sot, në datën 27. 09. 2006, u hartua Akti i Themelimit per krijimin e Shoqerise Anonime te emertuar "Tregu i shitjes me shumice Fruta Perime" Sh. a Shkoder, me aksionere te vetem Ministrine e Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes si perfaqesuese e prones shteterore, perfaqesuar nga z. Genc Ruli, Minister.

**NENI 1**

Themeluese e Shoqerise eshte Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, ne baze te ligjit Nr.7638, datë 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".

**NENI 2**
**EMERTIMI**

Shoqeria krijohet ne formen e nje Shoqerie Anonime dhe mban emrin "Tregu i shitjes me shumice Fruta–Perime" Sh.a. Shkoder, e cila do te jete e shenuar ne vulen e saj dhe do te paraqitet ne çdo dokument qe leshohet, firmoset e vuloset.

**NENI 3**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Shkoder. Ajo do ta ushtroje aktivitetin e saj brenda teritorit te Republikes se Shqiperise, duke pasur mundesine te hape filialet e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise.

**NENI 4**

Personalitetin e saj ligjor shoqeria e fiton nepermjet vendimit te Gjykates se rrethit Gjyqesor Tirane. Shoqeria ka nje kohëzgjatje te veprimtarise se saj te papercaktuar mbi 10 vjet.

**NENI 5**

Kapitali themeltar i shoqerise ka vleren 2,000,000 (dy milion) leke te ndare ne 2,000 aksione me vlere nominale 1,000 leke sejcili. Kontributi eshte shlyer plotesisht ne aksioneret.

**NENI 6**

Objekt i veprimtarise se shoqerise do te jete:

- Ngritja dhe funksionimi i tregut te shitjes me shumice te prodhimeve bujqesore te fresketa;
- Dhenia me qera e hapesirave dhe anbienteve te tregut me shumice individeve dhe firmave qe tregetojne prodhime bujqesore te fresketa,kryesisht fruta-perime;
- Dhenia me qera e hapesirave dhe ambienteve individeve dhe firmave qe sigurojne sherbima te ndryshme per perdoruesit e tregut me shumice,me qellim qe aktiviteti i tyre te jete sa me eficient;
- Nxitja e shitjes se prodhimeve bujqesore lokale,duke organizuar aktivitetet perkatese si panaire,ekspozita,si dhe promovime te prodhimeve lokale gjate gjithe vitit;

NENI 7
**ORGANET DREJTUESE**

- Veprimtaria e shoqerise kryhet nepermjet organeve drejtuese te saje qe jane:
  -Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve
  -Keshilli Mbikeqyres
  -Drejtoria
- Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullahet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.

Keshilli Mbikeqyres perbehet nga

1. Z. Kujtim Muça
2. Z. Nikoll Cupi
3. Zj. Eneida Guria
4. Zj. Voltana Ademi
5. Z. Nexhat Grezda
6. Zj. Terezina Hila

- Eksperte te pare kontabel te shoqerise do te jene:
  - Nurie Krymi.
  - ____________

Drejtor i shoqerise do te jete Z. Gëzim Rama.

**NENI 8**
Shoqeria fillon veprimtarine me nenshrimin dhe miratimin e dokumenteve te saj themeluese.

Firmosur me daten 27.09.2006

**MINISTRI**

**GENC RULI**

**Ne mungese dhe porosi**

**ZV/ MINISTRI**

**ENNO BOZDO**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES**
**DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE**
**DREJTORIA E PRIVATIZIMIT**

# URDHER

***Nr. 654 Datë 27.09 2006***

**PER**
**EMERIM NE KESHILLIN MBIKQYRES**

Mbështetur ne Ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare", në Ligjin nr. 7926, datë 20.04.1995, "Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare", i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.642, datë 11.10.2005, "Për Këshillat Mbikqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore,

**URDHEROJ:**

1. Emërimin në Këshillin Mbikqyrës të "Tregu i shitjes me shumicë të fruta perimeve" Sh.a, Shkoder:
    1. Z. Kujtim Muça, Projekti i Shërbimeve Bujqësore (ASP)
    2. Z. Nikoll Cupi, Specialist prane ASP
    3. Zj. Eneida Guria, Ekonomiste financiere (METE)
    4. Zj. Voltana Ademi, N/Kryetare Bashkia Shkoder
    5. Z. Nexhat Grezda, Bashkia Shkoder
    6. Zj. Terezina Hila, Universiteti Shkoder

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**GENC RULI**

**Ne mungese dhe porosi**

**ZV/MINISTRI**

**ENNO BOZDO**

Adresa: Blvd. "Zhan Dark"
E-mail: Kabineti@mete.gov.al
Internet : http//www.mete.gov.al

Tel : +355 4 226241
Tel : +355 4 223158
Fax : +355 4 234052

57 15/07/08

AGRICULTURAL SERVICES PROJECT

PROJEKTI I SHERBIMEVE BUJQESORE

PROJECT MENAGMENT UNIT (PMU)
NJESIA E MENAXHIMIT TE PROJEKTIT

Nr. 153 Prot Data 21/5/.2008

**Lenda: Per ndryshimin e anetarit te Keshillit Mbikqyres**

Drejtuar: **Z. Gezim Rama**
**Drejtor i Shoqerise Aksionere „ Tregu i Shitjes me Shumice Fruta Perime"**
**Shkoder**

Ne baze te se drejtes se ASP-se te percaktuar ne marreveshjen per ndertimin e tregut te fruta-perimeve te Shkodres midis ASP-se dhe Bashkise Shkoder, per caktimin e anetareve te Keshillit Mbikqyres, ne Keshillin Mbikqyres te kesaj shoqerie kryhet ndryshimi si me poshte:
- Anetari i keshillit mbikqyres Z. Roland Larashi zevendesohet nga Znj. Beatrice Bezhani.

Drejtoria e shoqerise te kryeje veprimet perkatese konform ketij ndryshimi

**Kujtim MUÇA**

**Drejtor Projekti**

Adresa : Rruga " Muhamet Gjollesha " Nr.56, Tirane, Tel&Fax 00355 4 235494 / 255135
P.O.Box. 1748, E-mail asproject@interalb.net

TREGU I SHUMICE

# REPUBLIKA E SHQIPËRISE
# BASHKIA SHKODËR

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr. 1, Shkoder
Tel./Fax: ++355 22 43720.

Nr. 58 Prot. Shkodër, më 2.7.2010

## Vendim

**Nr. 58, date 2/7/ 2010**

**Per emrimin e anetareve te keshillit mbikqyres te "Tregut me Shumice te Frutave - Perimeve ne qytetin Shkoder"**

**Ne mbeshtetje te ligjit Nr. 8652, date 31.07.2000, "Per Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore ", Kreu VI, neni 32, germa 1; Vendimit te Keshillit te Bashkise Shkoder nr. 74, date 02.10.2004, "Per miratimin e marreveshjes per ndertimin dhe funksionimin e tregut me shumice te fruta-perimeve ne qytetin e Shkodres ne mes te Bashkise Shkoder dhe Njesise se Menaxhimit te Projektit te Sherbimeve Bujqesore", dhe ligjit nr.7638, date 19.11.1992, seksioni II, neni 93" Per shoqerite tregtare" , Vendimin e Keshillit te Bashkise nr. 53, date 12.06.2006, neni 1, Per emrimin e anetareve te keshillit mbikqyres te "Tregut me Shumice te Frutave – Perimeve ne qytetin Shkoder"**

**Vendosa :**

1. **Lirimin nga detyra anetar te Keshillit Mbikqyres te "Tregut me shumice frutave-perimeve ne qytetin e Shkodres " te znj. Voltana Ademi dhe z. Nexhat Grezda.**
2. **Emerimin anetar te Keshillit Mbikqyres te "Tregut me shumice frutave-perimeve ne qytetin e Shkodres " te z. Ridvan Troshani Nenkryetar i Bashkise Shkoder dhe z. Blendi Gjylbegaj Drejtor i Drejtorise se Pergjithshme te te Ardhurave te Bashkise Shkoder.**
3. **Ky vendim hyn ne fuqi menjehere dhe I njoftohet sh.a "Tregut me Shumice te Frutave – Perimeve ne qytetin Shkoder"**

**Kryetari**
**Lorenc LUKA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA SHKODER

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

10668/ 2.2.2011

# URDHËR

Nr. 07 Datë 02.02.2011

**PËR**

**NDRYSHIM NË KËSHILLIN MBIKQYRES**

Mbështetur në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në Ligjin nr. 7926, datë 20.04.1995, "Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare", i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 642, datë 11.10.2005, "Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore,

**URDHËROJ :**

1. Lirimin nga detyra të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës në " Tregu i shitjes me shumice Fruta Perime " Sh.a. Shkodër,

   - Z. Kujtim MUÇA

2. Emërohet ne Këshillin Mbikëqyrës te " Tregu i shitjes me shumice Fruta Perime " Sh.a. Shkodër,

   - Z. Albert KUSHTI, Përfaqësues i MBUMK.

3. Ne zbatim te Ligjit nr. 9723, date 03.05.2007, "Për Qendren Kombetare te Regjistrimit" Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36, te bëhen ndryshimet përkatëse ne Regjister.

Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**NASIP NAÇO**

Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001 / Tel:+355 4 2 228 467 / 74 303 / E-mail: skocollari@mete.gov.al / Faqja web: http://www.mete.gov.al

Bardho

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

**URDHËR**

Nr. 197 Datë 20 / 3 /2014

**PËR**

**NDRYSHIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS**

Mbështetur në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në Ligjin Nr.7926,datë 20.04.1995 "Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare", i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 642, datë 11.10.2005 " Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore",

**URDHËROJ:**

1. Lirimin nga detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës në sh.a "Tregu i shitjes me shumicë Fruta - Perime" , Shkodër:

   -Zj. Eneida GURIA

2. Emërimin e anëtarit në Këshillin Mbikëqyrës të sh.a "Tregu i shitjes me shumicë Fruta - Perime" , Shkodër:

   -Z. Ylli MANJANI, Përfaqësues i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, nenet 32 e 36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Jonida Brahimaj

**ARBEN AHMETAJ**

**MINISTËR**

TIRANË

Bardha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

# URDHËR

Nr. 212 Datë 26/ 3 /2014

## PËR

## NDRYSHIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS

Mbështetur në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në Ligjin Nr.7926,datë 20.04.1995 "Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare", i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 642, datë 11.10.2005 " Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore",

**URDHËROJ:**

1. Lirimin nga detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës në sh.a "Tregu i shitjes me shumicë Fruta - Perime" , Shkodër:

   -Z. Geron IBRAHIMI

2. Emërimin e anëtarit në Këshillin Mbikëqyrës të sh.a "Tregu i shitjes me shumicë Fruta - Perime" , Shkodër:

   -Z. Arben MUKAJ, Përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, nenet 32 e 36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**ARBEN AHMETAJ**

**MINISTËR**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPERMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

# URDHËR

Nr.399 Datë 21/8/2014

**PËR**

**NDRYSHIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS**

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995. Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare" , i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 642, datë 11.10.2005 " Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore;

**URDHËROJ:**

1. Lirimin nga detyra të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës në sh.a " Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta Perime" Shkodër:

   - Z. Ritvan Troshani

2. Emërimin si anëtarë në Këshillin Mbikëqyrës të sh.a " Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta Perime" Shkodër:

   - Z. Kleves Janku. Përfaqësues i MBZHRAU-t.

3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Seksioni III. regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ARBEN AHMETAJ

MINISTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Tel: +35542200245; +35542448021

Nr._____Prot. Tiranë, më____/____/2015.

**URDHËR**

Nr.7763 Datë 12 / 10 /2015

**PËR**

**EMËRIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS**

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995, Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare" , i ndryshuar, dhe Vendimin Nr 642, datë 11.10.2005 " Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore;

**URDHËROJ:**

1. Emërimin si anëtar në Këshillin Mbikëqyrës të sh.a "Tregu me shumicë fruta perime ", Shkodër :

   - Z. Agron CEKA përfaqësues i MZHETTS .

2. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**ARBEN AHMETAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

**URDHËR**

Nr.6494 Datë 20 / 8 /2015

**PËR**

**LIRIMIN NGA KËSHILLI MBIKQYRËS**

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995, Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare" , i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 642, datë 11.10.2005 " Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore;

**URDHËROJ:**

1. Lirimin si anetar te Keshillit Mbikëqyrës në sh.a " Tregu i shitjes me shumice,Fruta-Perime" Shkodër:

   - Z. Ylli MANJANI

2. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**ARBEN AHMETAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Nr. 9517/3 Prot. Tiranë, më 15/1/2016

**Drejtuar: SHOQËRISË " TREGU I SHITJES ME SHUMICË FRUTA-PERIME " SHA**

**SHKODËR**

**Lënda:** *Dërgohen urdhrat për zbatim.*

Bashkëlidhur ju dërgojmë për zbatim Urdhrat Nr9517/1 dhe 9517/2, datë 11.1.2016 të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes "Për ndryshim në këshillin mbikëqyrës".

Në zbatim të Ligjit Nr. 9723 datë 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

**FREDERIK SEITI**

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Tel: ++35542200245; ++35542448021

Nr.____Prot. Tiranë, më___/___/2015.

**U R DH Ë R**

Nr. 9517/1 Datë 11/1/2016

**PËR**

**NDRYSHIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS**

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995, Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare" , i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 642, datë 11.10.2005 " Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore;

**URDHËROJ:**

**1.** Lirimin si anëtar në Këshillin Mbikëqyrës të " Tregu i shitjes me shumicë fruta-perime " sh.a, Shkodër :
   - Z.Arben MUKAJ

**2.** Emërimin si anëtar në Këshillin Mbikëqyrës të " Tregu i shitjes me shumicë fruta-perime " sh.a, Shkodër :
   - Zj.Barie REXHA

**3.** Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**ARBEN AHMETAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Tel: ++35542200245; ++35542448021

Nr.____Prot. Tiranë, më___/___/2015.

**U R DH Ë R**

Nr. 9517/2 Datë 11/1/2016

**PËR**

**NDRYSHIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS**

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995, Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare" , i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 642, datë 11.10.2005 " Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore;

**URDHËROJ:**

**1.** Lirimin si anëtar në Këshillin Mbikëqyrës të " Tregu i shitjes me shumicë fruta-perime " sh.a, Shkodër :
   - Z.Kleves JANKU

**2.** Emërimin si anëtar në Këshillin Mbikëqyrës të " Tregu i shitjes me shumicë fruta-perime " sh.a, Shkodër :
   - Zj.Mimoza SHAHINI

**3.** Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**ARBEN AHMETAJ**

VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTI SKENDERBEUT · 2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 15879/2 Prot. Tiranë, më 7-9 2018.

**Lënda :** **Qëndrimi që do të mbahet në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve në shoqërinë "Tregu i Shitjes me Shumicë " Fruta Perime " sha Shkodër.**

Bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me cilësinë e Aksionarit mazhoritar në shoqërinë "Tregu i Shitjes me shumicë "Fruta Perime" Sha Shkodër, në mbledhjen e datës 7 Shtator 2018, mban qëndrimin si më poshtë:

1. Miraton pikën 1 të rendit të ditës "Lirimin nga detyra të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës; Z. Blendi Gjylbegaj, Znj. Beatrice Bezhani dhe Znj. Terezina Hilaj".

**MINISTËR**

**Arben Ahmetaj**

VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT SKËNDERBEUT - 2018 -

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 2680/2 Prot. Tiranë, më 26. 3. 2018

## VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Nr. 45 Datë 26/ 3/2018

### PËR

### NDRYSHIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Ligjin Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare", i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 642, datë 11.10.2005 " Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore, me cilësinë e aksionarit mazhoritar ne shoqërinë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta Perime" Shkodër;

### VENDOSA:

1. Lirimin nga detyra të anëtarit të këshillit mbikëqyrës në "Tregu i shitjes me shumicë fruta perime" sha, Shkodër:
   - Znj. Mimoza Shahini
2. Emërimin si anëtar në këshillin mbikëqyrës të "Tregu i shitjes me shumicë fruta perime" sha, Shkodër:
   - Znj. Fotilda Dhimitri, përfaqësuese e MBZHR-së.
3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 , i ndryshuar" Për Regjistrimin e Biznesit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR**

**Arben Ahmetaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

**VENDIM**

**I**

**Asamblesë së ortakëve të shoqërisë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime" SH.A Shkodër**

**Nr.1 date 01.11.2018**

Asambleja e Ortakëve të shoqërisë "Tregu I Shitjes me Shumicë Fruta-Perime" sh.a Shkodër me aksionarë: Bashkia Shkodër me 32,78% të aksioneve përfaqsuar nga znj. Emilia Koliqi dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, zotërues i 67.21% të kapitalit themeltar të shoqërisë, përfaqsuar nga z. Stefan Kocollari, përfaqsues I aksionarit shtet me autorizim të Ministrit Nr 18413/1 datë 29.10.2018. Në mbledhjen e dates 01.11.2018 ora $11^{00}$, mbështetur në ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar:

**VENDOSI:**

1. Konfirmimin në detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikqyrës në shoqërinë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime" sh.a Shkodër:
   -Z.Agron Ceka

2. Emërimin si anëtare e këshillit mbikqyrës në shoqërinë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime" sh.a Shkodër:
   -Znj. Emilia Koliqi,përfaqsuese e Bashkisë Shkodër ne vend te perfaqesueses se Ministrise se Bujqesise dhe Zhvillimit Rural Znj. Barie Rexha.
3. Në zbatim të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, i ndryshuar "Për rregjistrimin e biznesit", seksioni III, rregjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në rregjistër.

4. Keto vendime hyjne në fuqi menjëherë.

**Përfaqsuesi i MFE**

Stefan Kocollari

**Përfaqsuesi i Bashkisë Shkodër**

Emilia Koliqi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË TREGU I SHITJES ME SHUMICË FRUTA PERIME SH.A SHKODËR

**Administratori I Shoqërisë**

Dritan Pirani

**VENDIM**

**I**

**Asamblesë së ortakëve të shoqërisë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime" SH.A Shkodër**

**Nr.1 date 19.07.2019**

Asambleja e Ortakëve të shoqërisë "Tregu I Shitjes me Shumicë Fruta-Perime" sh.a Shkodër me aksionarë: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, zotërues i 67.21% të kapitalit themeltar të shoqërisë, përfaqsuar nga znj Adriana Sheti, përfaqesues I aksionarit shtet me autorizim të Ministrit Nr 11751/2 datë 19.07.2019 dhe Bashkia Shkodër me 32,78% të aksioneve përfaqsuar nga znj. Jasmina Çekaj me autorizim te Kryetares se Bashkise nr 12349 date 16.07.2019. Në mbledhjen e dates 19.07.2019 ora $12^{00}$, mbështetur në ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar:

**VENDOSI:**

1. Znj. Fotilda Dhimitri, zevendesohet me znj.Rudina Suti, perfaqesuese e Ministrise se Bujqesise dhe Zhvillimit Rural, në Këshillin Mbikqyrës të shoqërinë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime" sh.a Shkodër.

2. Z.Agron Ceka, zevendesohet me Z.Denis Demiri, perfaqesues i Ministrise se Financave dhe Ekonomise, në Këshillin Mbikqyrës të shoqërinë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime" sh.a Shkodër.

3. Në zbatim të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, i ndryshuar "Për rregjistrimin e biznesit", seksioni III, rregjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në rregjistër.

4. Keto vendime hyjne në fuqi menjëherë.

**Përfaqsuesi i MFE**

Adriana Sheti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - TREGU I SHITJES ME SHUMICË FRUTA PERIME SH.A - SHKODËR

**Përfaqsuesi i Bashkisë Shkodër**

Jasmina Çekaj

**Administratori I Shoqërisë**

Dritan Pirani

**VENDIM**

**I**

**Asamblesë së ortakëve të shoqërisë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime" SH.A Shkodër**

**Nr.1 date 09.03.2020**

Asambleja e Ortakëve të shoqërisë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime" sh.a Shkodër me aksionarë: Bashkia Shkodër me 32,78% të aksioneve përfaqsuar nga znj. Jasmina Cekaj dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, zotërues i 67.21% të kapitalit themeltar të shoqërisë, përfaqsuar nga znj. Adriana Sheti, përfaqsues i aksionarit shtet me autorizim të Ministrit Nr 3731/1, date 28.02.20120 Në mbledhjen e dates 09.03.2020 ora $11^{00}$, mbështetur në ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar:

**VENDOSI:**

- Miratimin e ndryshimit ne Keshillin Mbikqyres te Shoqerise Z.Denis Demiri me Zj. Rezarta Mersini.
- Miratim i emerimit te Eksperteve Kontabel per pasqyren Financiare 2019,konkretisht znj.Liri Gjoka dhe znj.Ana Osmani.

1. Në zbatim të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, i ndryshuar "Për rregjistrimin e biznesit", seksioni III, rregjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në rregjistër.

2. Keto vendime hyjne në fuqi menjëherë.

**Përfaqsuesi i MFE**

Adriana Sheti

**Përfaqsuesi i Bashkisë Shkodër**

Jasmina Cekaj

**Administratori i Shoqërisë**

Dritan Pirani

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 2454 Prot. Tiranë, më 4 / 2 /2020.

**Lënda:** *Emërim Eksperti.*

**SH.A " TREGU I SHITJES ME SHUMICË "FRUTA PERIME "**

**SHKODËR**

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, për të kontrolluar dhe certifikuar llogarite vjetore, caktohen si Auditues Ligjor:

1. Znj. Liri Gjoka
2. Znj. Ana Osmani

Drejtoria para fillimit të punës harton me Ekspertin një projekt-marrëveshje për punën që do të kryhet, me përshkrimin e rubrikave të verifikimeve, kontrolleve, raportimeve etj, për përmbushjen e misionit, orët e punës te parashikuara si dhe honorarin gjithsej.

**MINISTËR**

**Anila Denaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË - TIRANË

Bulevardi"DëshmorëteKombit",Nr3;Tiranë, Albania; www.financa.gov.al; info@financa.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 12470 Prot. Tiranë, më 2.7.2020

# VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Nr. 71 Datë 2/7/2020

## PËR

## LIRIM NGA KËSHILLI MBIKQYRËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Ligjin Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare", i ndryshuar, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 570 , datë 03.10.2018 " Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Aksionare Shtetërore", me cilësinë e aksionarit mazhoritar të shoqërisë " Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta Perime" sha Shkodër;

## VENDOSA

1. Lirimin nga detyra të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës në shoqërinë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta Perime" sha Shkodër;

    - Znj. Rezarta Mersini;

2. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 , i ndryshuar" Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR**

**Anila Denaj**